

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

## KREU I EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË, SELIA, KOHËZGJATJÀ, OBJEKTI

### NENI 1 EMRI DHE FORMA E SHOQËRISË

- 1.1 Emri i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është TD PLASTIK Sh.P.K (më poshtë e quajtur "Shoqëria").
- 1.2 Shoqëria është e organizuar në formën e një shoqërie tregtare me përgjegjësi të kufizuar, në kuptim të Ligjit Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 1.3 Në rast transferimi të veprimtarisë tregtare mund të ruhet i njëjtë emërtim me kusht që pësoni juridik të shtojë në këtë emërtim një shënim i cili ka të bëjë me transferimin.

### NENI 2 SELIA

- 2.1.1 Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Sami Frasher", Pa.15, Ap.20, Shk.3, Njesia Bashkiake Nr.5, Tirane.
- 2.2 Asambleja e ortakeve mund të vendosë mbi transferimin e selisë së Shoqërisë në një adresë tjeter. Personat përgjegjës për administrimin e Shoqërisë mund të çelin ose mbyllin degë dhe/ose zyra përfaqësimi, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë.

### NENI 3 KOHËZGJATJA

- 3.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një përiudhe kohore me afat të pacaktuar duke filluar nga data e regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 4 OBJEKTI I SHOQËRISË

- 4.1 Shoqëria ka për objekt të saj kryerjen dhe marrjen pjesë në të gjitha aktivitetet që një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar mund të ushtrojë në bazë të legjislacionit shqiptar, dhe në veçanti:

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

Import-Eksport lende e parë për plastikë, prodhim me materiale plastike.  
Tregti e përgjithshme.

## KREU II KAPITALI I SHOQËRISË TRANSFERIMI I KUOTAVE FINANCIMI

### NENI 5 KAPITALI I SHOQËRISË

- 5.1** Kapitali i Shoqërisë është 1,000,000 ( një milion) lekë, i përbërë nga 2 (dy) kuota.

Ortakui i Shoqërisë **Z.Elton Cela** zotëron 1(një) kuotë që përfaqësohet 50% të kapitalit me vlerë 500,000 (pesë qindë mijë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Elton Çela**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 16 Mars 1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 037923953 dhe me ID:I30316201F, banues në Tiranë, pëson madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Ortakui i Shoqërisë **Z.Doraldo Morava** zotëron 1(një) kuotë që përfaqësohet 50% të kapitalit me vlerë 500,000 (pesë qindë mijë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z. Doraldo Morava**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 13 Korrik 1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 035337174 dhe me ID:I30713093D, banues në Tiranë, pëson madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar..

### NENI 6 TRANSFERIMI I KUOTAVE TË KAPITALIT TËK TË TRETËT

- 6.1** Kuotat e shoqërisë mund t'u transferohen lirisht të tretëve vetëm me miratimin nga Asambleja e ortakeve, sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- 6.2** Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim, pranë një noteri dhe i njoftohet shoqërisë.
- 6.3** Transferimi i tyre, merr vlerë vetëm pas regjistrimit të kalimit të kuotave pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

## NENI 7 BARRËT MBI KUOTAT E KAPITALIT

- 7.1 Kuotat e kapitalit të Shoqërisë mund të rendohen lirisht me barrë siguruese apo të drejta të tjera reale.

## KREU III NDRYSHIMI I KAPITALIT

### NENI 8

- 8.1 Zmadhimi i kapitalit themeltar me anën e kontributëve në natyrë apo zvogëlimi i tij bëhet me miratimin e Asamblese se Ortakeve mbi bazën e një projekti të paraqitur nga eksperti kontabël i autorizuar dhe me kërkesën e Asamblesë së Ortakeve apo Administratorit të Shoqërisë.
- 8.2 Zvogëlimi i kapitalit themeltar, bëhet në bazë të dispozitave të Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

## NENI 9 ZMADHIMI I KAPITALIT

- 9.1 Asambleja e Ortakëve mund të vendlës që rritja e kapitalit të bëhet dhe me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të cilat figurojnë deri në datën 31 dhjetor të vitit/vitëve financiar/financiare paraardhës/paraardhëse. Kjo gjë bëhet vetëm pasi Asambleja e Ortakëve, me vendim të ketë miratuar llogaritë vjetore të shoqërisë për vitin/vitët e mbyllur/mbyllura financiar/financiare paraardhës /paraardhëse.
- 9.2 Pas marrjes së një vendimi të tillë, Asambleja e Ortakeve cakton një ekspert kontabël të regjistruar për vlerësimin e zmadhimit të kapitalit themeltar me rezervat dhe fitimet e pashpérndara të shoqërisë, gjendje të datës 31 dhjetor të vitit paraardhës.
- 9.3 Pas prezantimit të aktit të vlerësimit nga eksperti kontabël i regjistruar, Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, me një vendim tjetër, përcakton mënyrën e rritjes së kapitalit themeltar të shoqërisë.

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

**9.4** Pas marjes së vendimit të dytë nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, e gjithë procedura e ndjekur në zbatim të këtij nënë do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit sipas parashikimeve të Ligjit Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

## KREU IV ORGANIZIMI I SHOQËRIS

### NENI 10 STRUKTURAT DREJTUESE DHE VENDIMMARRËSE

**10.1** Shoqëria tregtare TD PLASTIK Sh.P.K ka si struktura drejtuese dhe vendimmarrëse :

- Asambleja e Ortakeve të Shoqerise si organi vendimmarrës për shoqerinë;
- Administratorin

### NENI 11 DETÝRAT DHE PËRGJEGJËSITË E ORGANIT VENDIMMARRËS

**11.1** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, si organ vendimmarrës për shoqerinë, është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për pësonat e përmendor në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

**11.2** Asambleja e Ortakeve të Shoqerise merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës "1" të këtij nën, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.

**11.3.** Të gjitha vendimet e marra nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerisë do të regjistrohen në një regjistr të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Forma e regjistrat dhe mbajtja e vendimeve përcaktohen me vendim të Asamblese se Ortakeve të Shoqerise. Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, me vendim, mund të ngarkojë dhe një përsone fizik për mirëmbajtjen e regjistrat të mbledhjeve.

**11.4** Nga ana e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise merren të gjitha masat përkatëse për regjistrimin e vendimeve të saj pranë organëve përkatëse shtëtërore dhe sidomos në veçanti, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raportëve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- d) vendimet e marra në zbatim të nënëtit 9 të këtij statuti.

**11.5** Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishtë pasur dijeni për të.

NENI 12  
MBLEDHJA E ORGANIT VENDIMMARRËS

- 12.1 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise zhvillohet në rastët e përcaktuara nga Ligji Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare",, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nëvojshme për të mbrojtur intëresat e shoqërisë. Mbledhja e ortakut të vetëm thirret dhe zhvillohet të paktën një herë në vit.
- 12.2 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga kryesisht nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise ,administratori apo dhe nga eksperti kontabël i autorizuar kur ka nëvojë për diskutime për çështje ekonomike që lidhen me shoqërinë.
- 12.3 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise,thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
- 12.4 Mbledhja e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise thirret nga përsonat e tjerë të parashikuar nga pika 12.2 e këtij neni jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpara datës së parashikuar në mbledhjen e Asamblese se Ortakeve të Shoqerise. Mënyra e thirrjes së mbledhjes kryhet sipas përcaktimeve përkatëse të parashikuara Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 i ndryshuar "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KREU V  
ASAMBLEJA E ORTAKEVE, FINANCIMET

NENI 13  
ASAMBLEJA E ORTAKEVE

- 13.1 Ortakui i Shoqërisë **Z.Elton Cela** zotëron 1(një) kuotë që përfaqësohet 50% të kapitalit me vlerë 500,000 (pesë qindë mijë) Lekë i cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku **Z.Elton Cela**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 16 Mars 1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 037923953 dhe me ID:I30316201F, banues në Tiranë, përsone madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Ortakui i Shoqërisë **Z.Doraldo Morava** zotëron 1(një) kuotë që përfaqësohet 50% të kapitalit me vlerë 500,000 (pesë qindë mijë) Lekë i

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

cili është paguar tërësisht në para nga Ortaku Z. **Doraldo Morava**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 13 Korrik 1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 035337174 dhe me ID:I30713093D, bënues në Tiranë, pëson madhor e me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

## NENI 14 VENDIMET E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 14.1 Asambleja e Ortakëve të Shoqërise, në përputhje me legjislacionin shqiptar merr vendime në lidhje me: (i) ndryshimin e këtij Statuti, (ii) zmadhimin e zgjedhimit e kapitalit të Shoqërisë, (iii) kalimin e kuotave të Shoqërisë, (iv) emërimin dhe shkarkimin e Administratorëve si edhe emërimin e shkarkimin e ekspertit(ëve) kontabël të autorizuar, (v) miratimin e bilancit vjetor të Shoqërisë si edhe të çdo raporti tjeter finanziar, (vi) shndërrimin, shpërndarjen dhe likuidimin e Shoqërisë, (vii) emërimin e likuidatorit(ëve) dhe çdo vendim tjeter që sipas ligjit i takon Ortakut të Vetëm.
- 14.2 Asambleja e Ortakëve të Shoqërise duhet të merren me shkrim dhe të regjistrohen në regjistrin e mbajtur pranë selisë së Shoqërisë.

## NENI 15 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

- 15.1 Të drejtat dhe detyrat e Asamblesë së Ortakëve të Shoqërise janë:
  - Të marrë pjesë në mbledhjet e Asamblesë së Ortakeve të Shoqërise;
  - Të paraqesë pyetje me shkrim në lidhje me aktivitetin dhe administrimin e shoqërisë;
  - Të informohet mbi përbajtjen e raportit të administrimit, inventarët e llogaritë vjetore, tekstet e vendimeve të propozuara, si dhe raportin e ekspertit kontabël;
  - Të përfitojë nga fitimi i shoqërisë;
  - Të kërkojë prishjen e shoqërisë në rrethana të caktuara;

**NENI 16  
FINANCIMI I SHOQËRISË**

- 16.1** Organi i Administrimit të Shoqërisë, në përputhje me dispozitat në fuqi, përveç rasteve të zmadhimit të kapitalit, ka të drejtë të kërkojë nga ortakët e shoqërisë fondet e nevojshme pér arritjen e objektivave të shoqërisë.
- 16.2** Financimet e mëtëjshme të ortakeve në shoqëri do të jenë me shpërblim (interesa) apo pa shpërblim, në varësi të titullit nëpërmjet të cilit do të lëvrohen këto fonde.

**KREU VI  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

**NENI 17  
ADMINISTRIMI I SHOQËRISË**

- 17.1** Shoqëria administrohet nga 1 (një) Administrator i cili emërohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise pér një përiudhë 5 (pesë) vjeçare, me të drejtë rizgjedhje. Administratori i parë i Shoqërisë emërohet:  
**Z.Elton Çela**, shtetas shqiptar, lindur në Tiranë më 16 Mars 1983, mbajtës i letërnjoftimit me Nr. 037923953 dhe me ID:I30316201F, banues në Tiranë, përsone madhor e me zotësi të plotë juridike pér të vepruar
- 17.2** Në zbatim të këtij nenii, administratori i vetëm përfaqëson Shoqërinë kundrejt palëve të treta, përfshirë autoritetet publike dhe private, vendase ose të huaja, bankat, autoritetet tatimore dhe gjyqësore. Administratori është përgjegjës pér veprimet e kryera në administrimin e Shoqërisë sipas këtij akt themelimi dhe statuti e legjisacionit shqiptar.
- 17.3** Administratori mund të ndërmarrë apo kërkojë kryerjen e të gjitha akteve që konsideron të nëvojshme pér arritjen e objektit të Shoqërisë, përveç atyre që ligji apo statuti i rezervon Ortakut të Vetëm apo organëve të tjera të Shoqërisë.

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

## NENI 18 TË DREJTAT DHE DETYRAT E ADMINISTRATORIT

**18.1** Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumentë përpara Asamblese se Ortakëve të Shoqerise për miratim;
- d) krijojë një sistém paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që Kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistëncën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin Nr. 9723 datë 03. 05. 2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- e) raportojë përpara Asamblesë së Ortakëve të Shoqerise në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me të tretët;
- f) kryejë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

## NENI 19 PËRGJEGJËSIA E ADMINISTRATORIT

**19.1** Administratori është përgjegjës individualisht sipas rastit ndaj vetë shoqërisë ose ndaj të tretëve për shkelje të ligjeve, për shkelje të Statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## NENI 20 SHPËRBLIMI I ADMINISTRATORIT

**20.1** Asambleja e Ortakëve të Shoqerisë përcakton shpërblimin e Administratorit të shoqërisë.

KREU VII  
KONTROLLI I KONTABËL I SHOQËRISË  
VITI FINANCIAR DHE BILANI

NENI 21  
KONTROLLI KONTABËL

- 21.1 Kontrolli i jashtëm kontabël i Shoqërisë kryhet nga Ekspërtë Kontabël të Regjistruar, në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi. Asambleja e Ortakëve të Shoqërisë do të emërojë një apo më shumë ekspërtë kontabël në ato rastë kur emërimi i tyre konsiderohet i nevojshëm ose kërcohët në bazë të ligjit.
- 21.2 Për kompetencat, detyrimet, përgjegjësitë, zëvendësueshmërinë, tërheqjen, shkarkimin dhe shpërblimi i tij zbatohet legjislacioni shqiptar në fuqi.

NENI 22  
VITI FINANCIAR

- 22.1 Viti Financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.

NENI 23  
BILANI DHE REZERVAT

- 23.1 Me mbylljen e seclit vit financiar, Administratori merr masat e nevojshme për hartimin e bilancit të aktivitetit për vitin financiar të mbyllur, në mënyrë që Asambleja e Ortakëve të Shoqerise të vendosë mbi miratimin apo ndryshimet e mundshme të tij brenda afateve të përcaktuara nga ligji.
- 23.2 Asambleja e Ortakëve të Shoqerise vendos mbi ndarjen e dividendëve që rezultojnë si fitime sipas bilancit të miratuar rregullisht, pasi nga këto shuma të jenë zbritur humbjet e mundshme të vitéve të mëparshme.
- 23.3 Asambleja e Ortakëve të Shoqerise në çdo moment mund të vendosë kriçimin e rezervave, si edhe masën e tyre.

**NENI 24  
PUNËSIMI NË SHOQËRI**

**24.1** Të gjithë personat që do të punësohen pranë kësaj shoqërie, punësimi i tyre do të bëhet mbi bazën e kontratës individuale apo kolektive, sipas rastit, në të cilën do të përcaktohen të drejtat dhe detyrimet ligjore të secilës palë si dhe paga mujore në përputhje me legjislacionin shqiptar në këtë fushë.

**KREU VIII  
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 25  
PRISHJA DHE LIKUIDIMI I SHOQËRISË**

**25.1** Shoqëria mund të prishet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkaku, si në rast falimentimi, privim të të drejtave për të ushtruar aktivitet tregtar, forca madhore dhe faktorë të tjera që nuk varen nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise.

**25.2** Shoqëria hyn në fazën e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi, Asambleja e Ortakeve të Shoqerise emëron një ose disa likuidatorë, të cilët i paraqesin asaj raportin mbi gjendjen e aktivit dhe pasivit të Shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe afatin e nevojshëm të përfundimit të tyre. Shoqëria prishet në këto raste:

- Kur nuk mund të përbushet objekti për të cilin është krijuar shoqëria;
- Me vullnetin e ortakëve;
- Me vendim të Gjykatës
- Shkaqe të tjera të parashikuara në ligj

**NENI 26  
PROCEDURAT QË NDIQEN**

- 26.1** Likuidimi i shoqërisë tregtare TD PLASTIK SHPK vendozet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise kur prishet shoqëria.
- 26.2** Likuidimi i shoqërisë do të bëhet duke zgjedhur procedurën e zakonshme të parashikuar në Ligjin Nr. 9901 datë 14. 04. 2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".
- 26.3** Në qoftë se Asambleja e Ortakeve të Shoqerise, për mbylljen e parashikuar, nuk mund të marrë vendim ose ai nuk pranon të miratojë llogaritë e likuiduesit vendimi merret nga Gjykata me kërkesën e likuiduesit ose çdo përsoni të intëresuar.
- 26.4** Nëse nuk është proceduar si më sipër Gjykata me miratimin e Asambleja e Ortakeve të Shoqerise zbaton dispozitat ligjore dhe në se miratimi nuk është dhënë deri në seancën e parë gjyqësore ky miratim prezumohet i mirëqenë.
- 26.5** Në fund të procesit të likuidimit thirret Asambleja e Ortaeve të Shoqerise për të vëndosur në lidhje me bilancin finanziar përfundimtar.

**NENI 27  
NJOFTIMET**

- 27.1** Të gjitha njoftimet, kërkesat ose komunikimet e tjera që u jepen përsonave ose që bëjnë përsonat sipas Statutit do të kryhen me shkrim ose përmes komunikimit elektronik (nëse ka) dhe do të konsiderohen të kryera në mënyrë të rregullt kur u dërgohen në adresat e deklaruara prej tyre pranë Administratorit të Shoqërisë.

# TD PLASTIK Sh.P.K–STATUTI

- 27.2** Njoftimet zyrtare të komunikimeve me anë të mjetëve elektronike vërtetohen sipas Legjislacionit për nënshkrimin elektronik dhe dërgohen në adresat elektronike të deklaruara prej tyre.
- 27.3** Në rastin kur një kuotë zotërohet nga më shumë se një përson, të gjitha njoftimet do ti drejtohen përfaqësuesit të bashkëzotëruesve të kuotës.

## KREU IX BASHKIMI DHE NDARJA E SHOQËRISË

### NENI 28

- 28.1** Shoqëria TD PLASTIK Sh.P.K me anë të bashkimit mund t'i kalojë trashëgiminë e saj një shoqërie ekzistuese ose një shoqërie të re që ato themelojnë që ushtron të njëjtin aktivitet.
- 28.2** Gjithashtu shoqëria TD PLASTIK Sh.P.K me anë të ndarjes mund t'i kalojë trashëgiminë e saj disa shoqërive të tjera ekzistuese ose disa shoqërive të reja.
- 28.3** Në rast se opéracioni përfshin krijimin e shoqërive të reja secila prej tyre themelohet sipas rregullave që i TD PLASTIK Sh.P.K shoqërisë që do të krijohet.
- 28.4** Transferimi i plotë i aktivit të shoqërisë apo kontributi në aktiv të një shoqërie tjetër, veçanërisht me anë të procesit të bashkimit duhet të autorizohet nga Asambleja e Ortakeve të Shoqerise.

## KREU X DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

### NENI 29 LIGJI I ZBATUESHËM

- 29.1** Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë dhe Statut dhe me ligjin shqiptar. Për sa nuk është parashikuar në këtë akt, do

# TD PLASTIK Sh.P.K-STATUTI

të zbatohen dispozitat e legjislacionit shqiptar në fushën e shoqërive tregtare.

## NENI 30

- 30.1 Ky Statut përpilohet në 4 (katër) kopje origjinalë secili me të njëjtën vlerë ligjore. Njëri prej tyre ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë

Asambleja e Ortakëve të Shoqerise  
Të  
SHOQËRISË TD PLASTIK Sh.P.K

Elton Çela



Doraldo Morava



15.11.2024